



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1409/1 Prot.

Tiranë, më 27.05 2025

VENDIM

Nr. 61 dt. 27.05 2025

**“PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT TË NENIT 26 PIKA B) TË RREGULLORES PËR
ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PROMOVIMIT TË
PËRSONELIT AKADEMIK TË UST-SË (KPPA)”**

Në zbatim të nenit 38 të Ligjit nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit nr.57, datë 29.1.2020 “Për dhënien e statusit të vecantë të Universitetit të Sporteve të Tiranës si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e Sportit në Republikën e Shqipërisë”, nenit 20 të Statutit të UST-së, nenit 10 të Rregullores së UST-së, Vendimit nr.7, datë 08.05.2025 të Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik, Senati në mbledhjen e datës 27.05.2025,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të nenit 26 pika b) të Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Veprimtarisë së Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik të UST-së.
2. Neni 26 pika b) bëhet:
“Juria përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë që mbajnë titullin akademik “Profesor” nga e njëjta fushë ose nga fusha të ngjashme me atë të kandidatit, prej të cilëve, 3 (tre) janë personel akademik me kohë të plotë, të njësisë kryesore të Universitetit të Sporteve të Tiranës nga vjen kandidati dhe/ose i njësive të tjera kryesore të Universitetit të Tiranës që mbulojnë fusha të përafërta dhe 2 (dy) janë të ftuar nga jashtë UST-së. Të paktën dy anëtarë janë të së njëjtës fushë me atë të kandidatit.”
3. Ky Vendim i përcillet Njësive Kryesore, Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik dhe Drejtorisë së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
4. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT
Prof. Dr. Agron KASA

